



Pranimi / Datozuar Priliceni/Prilato Is Given/ Delivory	02.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednoca Org. Unit	Nr. Prilic It. Prilic Prilic No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3232/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.398/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.398/2022 të datës 19.04.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ përmes përfacësuesit të autorizuar avokatit _____ me adresë: _____ Komuna e Prishtinës, përmes postës së shpejt(mikmik), me numer dërgese PXTDTX5K, kundër organit të punësimit Komunes së Obiliqit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e **bazuar** ankesa me numër A.nr.398/2022 e datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesja _____
- II. **ANULOHET** Vendimi me numër XII-94 i datës 23.03.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunes së Obiliqit si dhe procedura e rekrutimit me numër reference RPC00017960, për grupin „Specialist të Shkencave Shoqërorë” për pozitën e punës “Zyrtar për bibliotekë 4”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Obiliqit .
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunes së Obiliqit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] ka aplikuar në konkursin me numër referencë RPC00017960, me emrin e grupit „ Specialist të Shkencave Shoqërorë” për pozitën: “Zyrtar për bibliotekë 4”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, e shpallur nga Komuna e Obiliqit sipas njoftimit datës 09.12.2021 për aplikim nga data 31.12.2021 deri me datë 11.01.2022, në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Me datë 23.03.2022 përmes e-mailit zyrtar është njoftuar nga Menaxherja e Personelit të Komunës së Obiliqit, lidhur me vlerësimin përfundimtar nga Komisioni për pranim, kundër mos përzgjedhjes se saj ne ketë pozite ankuesja me datë 30.03.2022 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i pranimit, i cili me datë 01.04.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit XII-139 me të cilën i ka refuzuar ankesën ankueses duke dhënë arsyetimin se është jashtë afatit, sepse për rezultatin përfundimtar është njoftuar për mes sistemit elektronik HRMIS dhe E-mailit njoftues të datës 23.03.2022, dhe e drejta për ankesë ka qene tri (3) ditë.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër protokollit XII-139 të datës 01.04.2022 të Kryetari i Komisionit të Pranimit, me datë 19.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit [REDACTED] me numër protokollit 2204/2022 e regjistruar me numër A.nr.398/2022, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar për bibliotekë 4”, me pretendime ankimore se nuk është njoftuar me kohë për rezultatin e procedurës se rekrutimit siç e përcakton dispozita ligjore ne fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te ankueses tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa Këshilli me datë 13.05.2022 ka pranua nga Komuna e Obiliqit përgjigjen e protokolluar me numër: 2789/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2204/2022 të datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; dëshmi nga sistemi elektronik i datës 24.03.2022 sipas ankesës dhe përgjigje e datës 01.04.2022 në ankesë nga sistemi elektronik; Ankesë e datës 24.03.2022; Publikimi i rezultateve me numër protokollit XII-94 me datë 23.03.2022; Shkresa e datës 01.04.2022 nga Komisioni i pranimit lidhur me ankesën; Njoftim me numër protokollit XII-05 i datës 21.01.2022; Autorizimi i datës 13.04.2022; Pliko postare të datës 16.04.2022 -posta mik mik me numë dërgese PXTDTX5K; Përgjigje në ankesë e datës 29.04.2022, nga Komuna e Obiliqit me numër protokollit 2789/2022; Konkursi i shpallur me datë 09.12.2021; Ankesa e datës 24.03.2022 e parashtruar tek Komisioni i pranimit; Shkresa zyrtare me numër protokollit XII-139 e datës 01.04.2022 e Kryesuesit të Komisionit të Pranimit; Vendim i datës 23.02.2022, përbërja e komisionit; Vendimi i datës 8.02.2022 për Ekspertë të jashtëm; Deklarata e datës 12.01.2022; Lista e aplikuarve; shkresa nga sistemi elektronik SIMBNJ; E-mail i datës 14.03.2022; Përfundim i vlerësimit i datës 01.04.2022 nga komisioni i pranimit; Renditja përfundimtarë e datës 23.03.2022; pasqyra e nxjerrë nga sistemi elektronik SIMBNJ-së; Prova shtesë e datës 31.05.2022 nga Menaxherja e personelit sipas kërkesës së datës 30.05.2022 të Këshillit; Lista e aplikuarve e nxjerrë nga SIMBNJ-së; Njoftimi i datës

21.01.2022 mbi verifikimin paraprak; Vendimi i datës 21.01.2022; Vendimi i datës 24.01.2022; Vendimi i datës 28.01.2022 nga Menaxherit i personelit; Vendim i datës 21.01.2022; Ankesa e datës 25.01.2022; E-mail i datës 14.03.2022; Lista e aplikantëve për grup-testi me shkrim e datës 07.03.2022; E-mail i datës 14.03.2022; Lista e aplikantëve për grup-testi elektronik i datës 07.03.2022; E-mail i datës 23.03.2022 për A.M; E-mail i datës 23.03.2022 për L.H; E-mail i datës 23.03.2022 për B.P; E-mail i datës 23.03.2022 për Z.K; E-mail i datës 23.03.2022 për I.H; E-mail i datës 23.03.2022 për L.B; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datë 23.03.2022; raport nga Komisioni pranimit i datës 23.03.2022; Përfundim i vlerësimit i datës 01.04.2022; Prova shtesë të datës 02.06.2022, Diplomë e datë 19.01.2018 nr. 068/18 lëshuar nga Kolegji AAB –titulli “Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve”, Certifikatë e datës 12 dhe 14.10.2021; Certifikatë e datë 01.12.2020; Certifikatë e datë 21.04.2019; Certifikatë e datë 26.09.2019; Certifikatë e datë 18.12.2015; Certifikatë e datë 20.06.2019; Certifikatë e datë 01.12.2014; Certifikatë e datë 30.10.2015; Certifikatë e datë 18.08.2013; Certifikatë e datë 18.12.2015; Letër reference e datë 01.12.2014; Certifikatë e datë 20.11.2004; Certifikatë e datë 02.04.2005; Referencë e datës 31.01.2019; aplikacioni i L.M.; Diplomë e datës 07.07.2014 lëshuar nga SH.M.M.“Ali Sokoli”, Certifikatë e datë 26.05.2014 lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë; Diplomë e datës 19.09.2018 lëshuar nga Universiteti i Prishtinë “Hasan Prishtina”, me titullin Bachelor - Jurisë i Diplomuar; Diplomë nr.2607 e datës 15.07.2021 lëshuar nga Universiteti i Prishtinë “Hasan Prishtina”, me titullin LL.M. Master në të drejtën Civile dhe Pronësore; Certifikatë e datës 10.01.2018; Certifikatë e datës 11.10.2018; Akt emërim i datës 30.11.2018; Certifikatë e datës 21.11.2019; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 10.03.2021; Referencë e datës 20.08.2019; Letër reference e datës 15.03.2019; Letër reference lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; e datës 15.03.2019; Referencë e datës 28.11.2019; Letër reference e datës 31.07.2019; Referencë e datës 31.01.2019; Deklaratë e datës 02.06.2022; Aplikacioni –CV e ankueses.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankuesit **është e bazuar,**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Obiliqit sipas njoftimit datës 09.12.2021 për aplikim nga data 31.12.2021 deri me datë 11.01.2022 ka shpallur konkursin me numër referencë RPC00017960, për grupin, „Specialist të Shkencave Shoqërore” për pozitën e punës - “Zyrtar për bibliotekë 4”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport” bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar tridhjetë (31) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur njëzet e tetë (28) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila ka marrë pjesë në testin me shkrim dhe testin me gojë, por nuk është përzgjedhur nga Komisioni i Pranimin sepse nuk i ka pasur mbi 70 pikë siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës “ ku kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë janë kandidatë fitues, ndërsa ankuesja në total ka pas 68.2 pikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se procedura e rekrutimit sipas njoftimit të datës 09/12/2021, i shpallur me datë 31.12.2021, për grupin „Specialist i Shkencave Shoqërore ” për pozitën “Zyrtar për bibliotekë 4”, në

Komunën e Obiliqit, me nr. reference RPC00017960, është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu ajo pretendon se Komisioni i pranimit nuk i ka bërë vlerësimin e drejtë dhe objektiv si në kualifikim, përvojë profesionale në test me shkrim dhe në intervistë me gojë, andaj propozon që ti aprovohet ankesa dhe të ndryshohet vlerësimi i komisionit intervistues dhe të shpallet kandidatë e suksesshme.

Sipas konkursit me numër reference RPC00017960, të datës 31.12.2021, për grupin „Specialist i Shkencave Shoqërore” për pozitën “Zyrtar për bibliotekë 4”, në Komunën e Obiliqit, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, fusha e kërkuar e arsimit: Ekonomik, Sociologji, Psikologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punës sociale;*
- *Përvoja e punës nuk është kërkuar.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se pretendimet e ankuses janë të qëndrueshme, sepse Komuna e Obiliqit procedurën e rekrutimit të shpallur sipas konkursit me numër referencë RPC00017960, për grupin „Specialist të Shkencave Shoqërore” për pozitën “Zyrtar për bibliotekë 4”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport të datës 31.12.2021, e ka zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës sepse pas administrimit të provave është konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, me rastin e formimit të listës së ngushtë me datë 21.01.2022 ka përfshirë kandidaten e cila nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, gjegjësisht nuk e ka plotësua kriterin lidhur me fushën e arsimit siç është kërkuar në konkurs.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të gjitha dëshmime për përvojën e punës të bashkëngjitura në dosjen e kandidatës së pranuar dhe në dosjen e ankuses, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, ka dështuar të vlerësoj drejtë dëshmitë e arsimit të kandidatës së përzgjedhur, sepse kandidatja e përzgjedhur bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit, nuk e ka plotësuar kriterin e lidhur me fushën e arsimit siç është kërkuar në konkurs, gjegjësisht nuk posedon diplome nga fusha e kërkuar e arsimit në konkurs, andaj Kolegji konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit me përfshirjen në listën e shkurtër të kandidatës së lartcekur që nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliken me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë.. ndërsa Komisioni i Pranimit me rastin e përzgjedhjes se kësaj kandidatë si kandidatë e suksesshme nuk ka respektuar dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është theksuar se: „Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen

e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive''.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit të lëndës dhe dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit për kandidaten e pranuar dhe ankuesen ka konstatuar, se kandidatja e suksesshme për grupin „*Specialist të Shkencave Shqërorë*” për pozitën e punës „*Zyrtar për bibliotekë 4*”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale sipas konkursit të shpallur të datës 31.12.2021 gjegjësisht kriterin e arsimit „*Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, fusha e kërkuar e arsimit: Ekonomik, Sociologji, Psikologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punës sociale;*” për shkak se: kandidatja ne baze te dëshmimeve te ofruara ne dosje me rastin e aplikimit posedon Diplomë me numër 5717 të datë 19.09.2018, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina ” me të cilin dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Juridik me datë 28.06.2018 dhe ka marr titullin Juriste e diplomuar-Bachelor, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave sipas dëshmimeve të lartpërmendura për arsimimin të ofruara në dosje nga Komuna e Obiliqit, ka konstatuar që kandidatja e përzgjedhur e nuk e ka plotësuar *kriterin e konkursit, sa i përket fushës se kërkuar të arsimit, ndërsa ankuesja ne baze te dëshmimeve te ofruara ne dosje me rastin e aplikimit posedon Diplomë me numër 068/18 të datë 19.01.2018, lëshuar nga Kolegji AAB, me te cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet ne programin „Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve”, me datë 07.10.2013, dhe ka merr titullin: Bachelor në Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve”. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave sipas dëshmimeve të lartpërmendura për fushën e arsimit të ofruar në dosje nga Komuna e Obiliqit, ka konstatuar që ankuesja e ka plotësuar *kriterin e konkursit, sa i përket fushës se arsimit qe duhet të ketë, „ Diplomë/a të studimeve univërsitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, fusha e kërkuar e arsimit: Ekonomik, Sociologji, Psikologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punës sociale”**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marre parasysh shkeljet procedurale dhe ligjore të theksuara më lartë, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive’* dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil,.

Bazuar në konstatimet si me lartë, e meqenëse janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së një procedure rekrutimi e përfshirë më shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedure e paligjshme, kështu që Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.398/2022.

Zyle ~~Milaku~~ GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI ~~BAJRAKTARI~~

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar _____ (për ankuesen _____);
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;